



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 399/1 Prot.

Tiranë më 08.05 2020

VENDIM

Nr. 61 datë 08.05.2020

"PËR MARRJEN E MASAVE PËR MBYLLJEN E VITIT AKADEMIK 2019-2020, PËR SHKAK TË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS"


Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr.104 dt. 30.04.2020, "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19", ne bashkërendim me të gjitha strukturat akademike dhe administrative të rektoratit dhe njërive kryesore, rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës

VENDOSI:

- Marrjen e masave të nevojshme të të gjitha strukturave drejtuese akademike dhe administrative të UPT për rikthimin në auditorë të studentëve sipas dy fazave të parashikuara në urdhrin 104 të ministrit të MASR:
 - 01.06.2020 – 07.08.2020, për studentet e të gjitha cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020
 - 25.08.2020 – 31.10.2020, për studentët e viteve të para dhe viteve të ndërmjetme në të gjitha ciklet e studimit,dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2020, referuar këtij urdhri në datë 31.10.2020
- Vijimin e mësimin online rregullisht deri në mbylljen e aktivitetit mësimor për të gjitha programet e studimit, në përputhje me planet mësimore, duke respektuar strukturën mësimore të miratuar nga Rektorati i UPT, në lidhje me situatën e krijuar nga COVID-19.
- Referuar pikave 1.a, 1.b të urdhrin nr.104 të ministrit të MASR, për studentët e të gjitha cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020,
 - Koha e rikuperimit të problematikave që mund të jenë hasur gjatë aktivitetit akademik, në lidhje me ndonjë leksion/seminar, apo laboratorët, praktikat, detyrat, projektet, etj., do të jetë 3 javë, 01.06.2020 – 21.06.2020. Fakultetet kanë fleksibilitet në përcaktimin e prioriteteve dhe format e zhvillimit dhe realizimit të tyre.

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

- Sesioni i provimeve të jetë 22.06.2020– 26.07.2020. Java e parë e sesionit të shfrytëzohet për provimet e pamundësuar nga semestri i parë.
Sesioni i mbrojtjes së diplomave të jetë 27.07.2020 – 07.08.2020
4. Referuar pikave 1.d, 1.e të urdhrit nr.104 të ministrit të MASR, për studentët e viteve të para dhe viteve të ndërmjetme në të gjitha ciklet e studimit,
- Koha e rikuperimit të problematikave që mund të jenë hasur gjatë aktivitetit akademik, në lidhje me ndonjë leksion/seminar, apo laboratorët, praktikat, detyrat projektet etj., do të jetë 4 javë, 25.08.2020 – 20.09.2020. Fakultetet kanë fleksibilitet në përcaktimin e prioritetëve dhe format e zhvillimit dhe realizimit të tyre.
 - Sesioni i provimeve të jetë 21.09.2020– 18.10.2020. Java e parë e sesionit të shfrytëzohet për provimet e pamundësuar nga semestri i parë.
Sesioni i provimeve të vjeshtës dhe diplomave të jetë 19.10.2020 – 31.10.2020.
5. Ngarkohen drejtuesit e njësive kryesore, në bashkëpunim me administratorët dhe drejtuesit e njësive bazë të fakulteteve, për të përgatitur, paraqitur në faqen zyrtare të secilit fakultet dhe zbatuar planin e detajuar të masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, në të cilin përfshihen numri i saktë i studentëve që frekuentojnë programet e studimit dhe hapësirat fizike në dispozicion të tyre me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe pedagogëve në raport me format përcaktuara të zhvillimit dhe kontrollit të aktivitetit mësimor.
6. Ngarkohet Administratori i UPT, për sigurimin e masave administrative për higjienizimin dhe dezinfektimin e ambienteve, sipas rregullores së miratuar nga MASR dhe rekomandimeve të ISHP dhe, mbi këtë bazë, të hartojë dhe paraqesë për miratim rregulloren e brendshme për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në UPT, deri në datë 13.05.2020.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UPT, zëvendësrektorët, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë, drejtuesit e drejtorive dhe strukturat e tjera të UPT.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Rektori
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë.
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al